



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Prishtinës bënë:

SHPALLJE PUBLIKE
Për plotësimin e pozitës për kryerjen e shërbimeve të veçanta:

DREJTORIA E FINANCAVE

TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Operator i futjes së të dhënave

NIVELI I PAGËS: 407 euro

NUMRI I EKZEKUTUESVE: katër (4) ekzekutues/e

PERIUDHA: Gjashtë (6) muaj

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Bënë futjen e të dhënave në program;
- Bën regjistrimin e pagesave në mënyrë automatike;
- Administron sistemin për menaxhimin e tatimit në pronë dhe vlerësimin të pronës sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi;
- Sipas nevojës, u shërben palëve në dhënien e informatave lidhur me obligimet e tyre për çështjen e të dhënave të pronave;
- Kryen dhe punë të tjera që mund t'ia caktojë Udhëheqësi i drejtpërdrejtë.

KUSHTET:

- Diplomë universitare;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Aftësi të koordinimit dhe mbikëqyrjes së punës;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Aplikantët e suksesshëm duhet të paraqesin:

- Një letër motivuese;
- CV/Resume dhe certifikatën e notave apo diplomën.
- Një ese, lidhur me pozitën e shpallur.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk merret parasysh.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Data e shpalljes 23.08.2018 deri me dt. 29.08.2018

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e komunës së vjetër.

Në intervistë me gojë, ftohen vetëm aplikantët nga Lista e ngushtë, e cila hartohet mbi bazën e kriterëve të konkursit dhe vlerësimit të esesë dhe letrës motivuese.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Sektorin e Burimeve Njerëzore, zyra nr. 40, në këtë nr. të telefonit 038/230-900 lokali 10-70.